TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. I/110
Dt. 25.05.2015
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

2015

HEKURUDHAT E KOSOVËS

Raport Tremujor

Janar - Mars 2015



Fushë Kosovë
Prill 2015

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

I. HYRJE..... 2

II. STRUKTURA ORGANIZATIVE E TRAINKOS SH.A..... 3

III. PERFORMANCA FINANCIARE..... 8

IV. PERFORMANCA OPERATIVE 13

V. PROJEKTET KAPITALE TË TRAINKOS SH.A..... 22

VI. KONTESTET GJYQËSORE NË PERIUDHËN JANAR-MARS 2015..... 25

VII. TRANSAKSIONET E REALIZUARA JANAR-MARS 2015..... .29

VIII. SFIDAT DHE MASAT PËR NGRITJEN E PERFORMANCËS..... 30

I. HYRJE

Raporti i tre mujorit të parë të vitit 2015, për ndërmarrjen publike Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A. reflekton angazhimin, përformancen dhe sfidat që po e përcjellin kompaninë në veprimtarinë e saj. Ky raport paraqet qartë aktivitetet që kemi pasur gjatë këtij tremujori në funksion të arritjes së objektivave të vendosura me Planin e Biznesit. Në anën tjetër raporti do të pasqyrojë vështirësitë dhe sfidat që has kompania gjatë zhvillimit të aktivitetit të saj. Sfida këto që nuk janë të reja dhe kanë ndikim të drejtpërdrejt në arritjen e objektivave tona biznesore.

Në këtë tremujor ndërmarrja ka arritur objektivat në transportin e mallrave, ky është indikator i cili tregon se transporti i mallrave si aktiviteti më i rëndësishëm biznesor i kompanisë ka një kontinuitet pozitiv. Gjatë kësaj periudhe jemi angazhuar maksimalisht që ta zhvillojmë edhe më tutje këtë shërbim fitimprurës për kompaninë. Në kuadër të këtij angazhimi kemi zhvilluar takime me klientë potencialë, të cilëve u është shpalosur oferta jonë për transport të mallrave duke vënë në pah përkushtimin tonë ndaj klientëve dhe përparësitë e ofertës sonë në raport më transportuesit tjerë. Sfidë në realizimin e suksesshëm të shërbimeve në transportin e mallrave, mbetet gjendja e mjeteve lëvizëse dhe mungesa e tyre.

Sfidat kryesore paraqiten tek shërbimet në transportin e udhëtarëve. Tremujor i parë i vitit 2015 jep indikatorë të qartë se pothuajse është e pamundur të arrihen objektivat në ketë shërbim, për disa arsye që tashme janë të njohura. Mos mbulimi i shpenzimeve të transportit të udhëtarëve nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës sipas Ligjit të Hekurudhave në Kosovë, ka qenë sfidë për kompaninë edhe më herët, për me keq, këtë vit ministria ka bërë reduktimin e mbulimit të shpenzimeve në marrëveshjen për OSHP-në nga 931.959.00 €, që ishte vitin e kaluar në 1.041.959.00 €. Ky reduktim do të ndikon drejtpërsëdrejti në arritjen e objektivave tw përcaktuara në Planin e Biznesit për vitin 2015.


Vështirësitë tjera janë te aspektit teknik, të cilat në vazhdimësi janë shoqëruar me defekte dhe që kanë shkaktuar vonesa dhe kanë ndikuar në kushtet e transportit. Një gjë e tillë ka ndikuar dukshëm në rënien e numrit të udhëtarëve gjatë sezonit të dimrit. Sfide tjetër është padyshim nevoja për një organizim më funksional të sektorit dhe masat që duhet të merren në funksion të rritjes së efikasitetit në shitjet e këtij shërbimi.

Në përgjithësi mund të konstatojmë se tremujori i parë i këtij viti i paraqitur në këtë raport është i kënaqshëm, do të dëshironim një përformancë edhe më të mirë. Gjithsesi, indikatorët e këtij raporti do na shërbejnë për të përcaktuar veprimet konkrete në funksion të ngritjes së performancës në të gjithë sektorët dhe shërbimet që ofron kompania.

II. STRUKTURA ORGANIZATIVE E TRAINKOS SH.A

II.1. Skema organizative e HK-Trainkos Sh.A.

Hekurudhat e Kosovës HK-Trainkos Sh.A., brenda periudhës tremujore (01.01.2015-31.03.2015), në numrin e përgjithshëm të të punësuarve kanë pasur disa ndryshime të cilat kanë reflektuar edhe në përqindje në strukturën e përgjithshme të të punësuarve. Në tabelën në vijim do të paraqesim gjendjen e të punësuarve në kompani më 01.01.2015 dhe më 31.03.2015, duke filluar nga numri i përgjithshëm i punonjëseve, mosha mesatare, punëtorët me kontratë të afatizuar dhe të pa afatizuar etj. Më pas do të paraqiten edhe aktivitetet dhe punët tjera të këtij sektori.



Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, mosha e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në Trainkos SH.A. është si vijon:

Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të Trainkos SH.A. më 1 janar 2015 dhe më 31 mars 2015					
Totali i të punësuarve	01.01.2015		31 .03.2015		
	222		220		
Vlerat	Vlerat në numra		Vlerat në përqindje		
Datat	01.01.2015	31.03.2015	01.01.2015	31.03.2015	
Mosha mesatare e punëtorëve	46.82	46.81	%	%	
Me marrëdhënie të rregullt pune	222	220	%	%	Format e kontratave
Me kontratë të paafatizuar	75	74	37.78 %	33.63 %	
Me kontratë të afatizuar	147	146	66.21 %	66.36 %	
Meshkuj	199	197	89.63 %	89.54 %	Gjinia
Femra	23	23	10.36 %	10.45 %	
Serb	2	2	0.90 %	0.90 %	Nacionalitet
Shqiptarë	220	218	99.09 %	99.09 %	
Me shkollim fillor	17	17	7.65%	7.72 %	Shkollimi
Shkollim Të mesëm	155	131	69.81%	59.54 %	
Kualifikim profesional	%	22	%	10.00%	
Me shkollim të lartë	4	4	1.8%	1.81 %	
Me shkollim superior	46	46	20.72%	20.90 %	
Departamenti i Operimeve	137	135	61.71 %	61.36 %	Përshkrimi i Departamenteve
Departamenti i Administratës	43	43	19.36 %	19.54 %	
Departamenti i Financave	8	8	3.60%	3.63 %	
Departamenti i Zhvillimit	6	6	2.70 %	2.72 %	
Kabineti i KE-së	7	7	3.15 %	3.18 %	Kabineti i KE-së dhe Zyret në kuadër të KE-
Zyra e Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit	15	15	6.75 %	6.81 %	
Zyra për Marrëdhënie me Publikun	3	3	1.35 %	1.36 %	
Zyra e Prokurimit	3	3	1.35 %	1.36 %	

Vërejtje: Tabela më lart nuk përmban anëtarët e Bordit të Drejtorëve.

Sqarim i tabelës më lart:

Numri i përgjithshëm i të punësuarve më dt. 01.01.2015, ka qenë 222 të punësuar.

Më dt. 31.12.2014, është bërë një shkëputje e marrëdhënies se punës me dëshirë, ku ka ulur numrin për një të punësuar. Numri i përgjithshëm i të punësuarve më dt. 31.03.2015 është 220.

Gjatë periudhës janar – mars marrëdhënia e punës sipas fuqisë ligjore ju ka ndërprerë dy punëtorëve (shkuarje në pension), kështu që më dt. 31.03.2015, Trainkos SH.A. regjistron 220 punëtorë.

Në tabelën më lart nuk janë përfshirë punëtorët me kontratë specifike për arsye se në raportet e kaluara ndryshimi i shpeshtë i këtyre punëtorëve e ka komplikuar tabelën.
Pra, gjatë periudhws. 01.01.2015 deri me dt. 31.03.2015, kemi pasur 8 punëtorë me kontratë specifike.

Përmbushja e objektivave nga Plani i Biznesit të SÇL dhe RNJ, për periudhën kohore 01.01.2015 gjerë me dt. 31.03.2015:

1. Menaxhimi i rregullt i resurseve njerëzore (punësimi, largimi, pensionimi);
2. Organizimi dhe mbikëqyrja e kontrollimeve të rregullta mjekësore të punëtorëve;
3. Mbrojtja e shëndetit dhe ambientit dhe siguria në punë;
4. Disiplina në punë dhe respektimi i orarit të punës;
5. Hartimi dhe ndryshimi – plotësimi i akteve normative të Trainkos SH.A. harmonizimi i tyre me aktet juridike dhe legjislacionin në fuqi;
6. Planifikimi dhe mbikëqyrja administrative e shfrytëzimit të pushimeve vjetore;
7. Arkiva;
8. Lëndët gjyqësore dhe
9. Rastet e jashtëzakonshme.

II.2. Menaxhimi i rregullt i Resurseve njerëzore (punësimi, largimi, pensionimi dhe pajisja e punëtorëve me kontrata)

II.2.1. Hekurudhat e Kosovës - Trainkos SH.A.

Në këtë periudhë kemi pasur 2 pensionime të rregullta, është pensionuar - Osman Kelmendi Mbikëqyrës i Lokomotivave Departamenti i Operimeve dhe Ilmi Berisha - Depoist Doganor Departamenti i Operimeve, të lartcekurve u janë kryer të gjitha procedurat e pensionimit si: Mbyllja e librezës, vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe u është paguar shuma në bazë të Rregullores për të Ardhurat dhe kompensimet tjera në Trainkos SH.A.

II.2.2. Organizimi dhe mbikëqyrja e kontrollimeve të rregullta mjekësore të punëtorëve

Në mënyrë që komunikacioni hekurudhor të jetë sa më i sigurt, Sektori për Çështje Ligjore dhe Resurse Njerëzore është i obliguar që të përcjellin gjendjen psiko-fizike të punëtorëve. Këtë e bëjnë përmes kontrollimit sistematik mjekësor të tyre, në bazë të kushteve dhe kritereve të parapara në Rregulloren mbi aftësinë psiko-fizike të punëtorëve, të cilët drejtpërdrejtë marrin pjesë në komunikacionin hekurudhor. Kemi bërë përgatitjen e regjistrave të punëtorëve të cilët do të dërgohen në kontrollim mjekësor periodik në këtë periudhë.

Nga data 01.01.2015 gjerë më datën 31.03.2015, në kontrollim mjekësor janë dërguar 25 punëtorë. Prej 25 punëtorëve të cilët kanë qenë në kontrollim sistematik të gjithë e kanë marrë grupen mjekësore. Kontrollimi është kryer nga Instituti i Mjekësisë së Punës në Obiliq.

II.2.3. Disiplina në Punë dhe Respektimi i Orarit të Punës

Gjatë kësaj periudhe tremujore nga data 01.01.2015 deri 31.03.2015, nuk është regjistruar asnjë lëndë disiplinore. Duhet cekur te respektimi i orarit të punës në këtë periudhë në objektin e Administratës në listën e nënshkrimeve për ardhje dhe dalje nga puna është përfshirë edhe menaxhmenti.

Sektori për Çështje Ligjore dhe RNJ vazhdimisht ka bërë vizita për respektimin e orarit të punës në objektin e Tërheqjes së Trenave dhe Punëtorinë e Vagonëve.

II.2.4. Hartimi dhe ndryshim plotësimi i akteve normative në Trainkos SH.A. harmonizimi i tyre me aktet juridike të vendit dhe zbatimi i ligjshmërisë në Trainkos SH.A.

Gjatë muajve janar – mars 2015, janë aprovuar këto Rregullore dhe Udhëzime:

1. Udhëzimi mbi Pirjen e Duhanit në Hekurudhat e Kosovës – Trainkos – SH.A,
2. Udhëzimi për Llogaritjen dhe Aplikimin e RIV-it,
3. Rregullore Mbi Punën e Arkës dhe Përdorimin e Parave të Gatshme,
4. Rregullore Mbi Udhëtimet Zyrtare në Hekurudhat e Kosovës – Trainkos – SH.A.

Gjatë muajve janar – mars 2015, janë formuar komisione dhe kanë filluar punën për këto Rregullore dhe Udhëzime:

1. Udhëzimi mbi Procedurat e Kalkulimit,
2. Udhëzimi mbi Procedurat dhe Procesin e Shitjes,
3. Udhëzimi Dokumentit Unik mbi Përdorimin e Pjesëve Rezervë dhe Materialit Shpenzues,
4. Udhëzimi për Tërheqje të Trenave nga Binarët Industrial në Stacion,
5. Udhëzimi për Organizimin e Shkollimit të Rregullt të Punëtorëve në Sektorin e Transportit,
6. Rregullorja mbi Kushtet Shëndetësore të cilat duhet t'i plotësojnë Punonjësit,
7. Rregullorja 241 për Mirëmbajtjen e Mjeteve Lëvizëse dhe
8. Rregullorja për Mbrojtje në Punë.

II.2.5. Planifikimi dhe mbikëqyrja administrative e shfrytëzimit të pushimeve vjetore

Pushimin vjetor për vitin 2014 deri me 31.03.2015, e kanë shfrytëzuar 204 punëtorë, ndërsa afati për shfrytëzimin e pushimit vjetor të vitit 2014, sipas Rregullores është deri më 30 Qershor 2015. Pushimin vjetor për vitin 2015, e kanë shfrytëzuar 26 punëtorë. Gjatë kësaj periudhe Janar-– Mars 2015, në pushim mjekësor kanë qenë 12 punëtorë, pushimin statusor e kanë shfrytëzuar 5 punëtorë, kërkesë ditore kanë ushtruar 46 punëtorë dhe ndalesa administrative kanë qenë gjithsej 10.

II.2.5. Rastet e jashtëzakonshme

Duhet cekur se Sektori për çështje Ligjore dhe Resurse Njerëzore në kuadër të detyrave të veta përfshin edhe rastet e jashtëzakonshme ku për këtë detyrë angazhohet në mbrojtje të personelit të trenave në rast të ndalimit nga organet kompetente në rast aksidenti, kompleton dokumentacionin e nevojshëm për PK, ofrimin e provave në rast aksidenti të cilat i siguron nga sektorët tjerë dhe me ata që i posedon dhe të gjithë këto prova i dërgon në PK. Këto i detyra i kryen Zyrtari Ligjor për raste të jashtëzakonshme i emëruar nga Kryeshefi Ekzekutiv.
Nga data 01.01.2015 deri më 31.03.2015, kanë ndodhur tri aksidente:

1. **Aksidenti i dt. 21.01.2015;**
2. **Aksidenti i dt. 09.02.2015;**
3. **Aksidenti i dt. 13.02.2015.**

Për secilin rast janë përgatitur raportet me të gjitha provat e nevojshme për Policinë e Kosovës – Njësitin e Hetuesisë.

III. PERFORMANCA FINANCIARE E TRAINKOS SH.A.

TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR

1. *Gjendja financiare janar – mars 2015*
2. *Gjendja në para të gatshme - raporti sipas bankës (31.03.2015)*

III.1. Gjendja financiare Janar – Mars 2014

Për periudhën raportuese Janar – Mars 2015, gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzime është si vijon:

III.1.1. Të hyrat

- Nga **Transporti i mallrave** kemi realizuar të hyrat prej 501.561.03 €, për periudhën Janar – Mars 2015. Totali i të hyrave të planifikuara për vitin 2015, është 2.653.841.23 € dhe nga kjo del se kemi realizuar 18.9 % nga totali. Të hyrat nga transporti i mallrave eksport/import, janë realizuar sipas kategorive që pasojnë: të hyrat nga importi i kemi realizuar përmes vijës kufitare Hani i Elezit, janë 107.622.97 € dhe nga eksporti po ashtu përmes vijës kufitare Hani i Elezit, kemi realizuar shumën prej 8.254.89 €. Transporti i brendshëm kryesisht është realizuar për "New Co Ferronikeli" dhe atë në transportin e xehes nga Medveci dhe thëngjillit nga Kastrioti. Në këtë periudhë nga ky lloj i transportit është realizuar shuma prej 385.683.17 €.

- **Transporti i udhëtarëve** për periudhën janar – mars 2015, është realizuar në shumën prej 173.773.50 €. Nga të hyrat e faturuara nga Transporti i Kontraktuar priten 240.554.37 €, nga të hyrat e planifikuara nga Subvencioni për mbulimin e pjesshëm të humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve kemi realizuar shumën prej 125.000.00 €. Burimi i të ardhurave nga biletat është realizuar në shumën prej 48.773.52 €. Shprehur në përqindje me realizimin e të hyrave nga transporti i udhëtarëve kemi arritur shumën e realizimit prej 9.23 %, krahasuar me planifikimet për tërë vitin 2015.

- **Të hyrat nga shërbimet tjera** gjatë periudhës janar – mars 2015, kanë arritur shumën prej 53.246.23 €. Kjo shumë nëse krahasohet me shumën e buxhetuar për vitin 2015, e cila është 74.686.68 €, arrin kuotën prej 71.29 %. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionet siç vijojnë: Të hyrat e tjera nga kontejnerët dhe shërbimi për ta – 41.580.00 € dhe të hyrat nga RIV – i dhe vendosjet – 11.666.23 €.

- **Të hyra tjera,** të cilat janë planifikuar gjatë periudhës janar – mars 2015, kanë arritur shumën prej 17.738.37 €. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionet siç vijojnë:
Të hyrat nga dëmtimi i vagonëve – 6.791.38 € dhe të hyrat nga shitja e derivateve për Infrakos Sh.A. - 10.946.99 €. Buxheti i planifikuar është 205.000.00 €, shprehur ne përqindjen 8.65 %.

- Shuma e **Donacionit nga Buxheti i Kosovës** prej 1.091.859.00 €, për projektet kapitale të parashikuara ende nuk është transferuar, nëse e kemi parasysh se projektet janë në fazën e procedurave të prokurimit dhe praktikat e caktuara nga zyrtarët qeveritarë që transferimi i mjeteve bëhet me t'u finalizuar puna rreth një situacioni të projektit apo i tërë projektit

III.1.2. Shpenzimet

- **Shpenzimet** për periudhën janar – mars 2015, ashtu edhe siç janë buxhetuar janë të klasifikuara në kategoritë që pasojnë:

- **Totali i kostos së shërbimit** për periudhën është 469.655.71 € nga 2.631.414.24 € të planifikuara për vitin 2015 dhe arrijnë kuotën prej 17.85 %. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – mars 2015. Vlen të theksohet se kostoja e shërbimeve është një shpenzim më i lartë duke e pasur parasysh se janë shpenzimet e naftës të cilat kapin vlerën totale 254.131.92 €.

- **Shpenzimet e stafit** është kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur shumën prej 427.033.99 €, dhe atë në paga dhe kontribute – 425.580.99 € dhe sigurimi shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera – 1.453.00 €. Në total nëse e krahasojmë periudhën janar – mars me shumën e buxhetuar për tërë vitin në këtë kategori kemi arritur kuotën prej 26.06 %. Shpenzimet e stafit kanë pësuar një rritje për arsye se është realizuar kontrata kolektive, konkretisht stazhi i punëtoreve.

- **Totali i shpenzimeve operative** kap shumën prej 28,375.20 €, kjo shumë është vetëm 7.37% nga shuma prej 384,900.00 € e parashikuar për vitin 2015. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – mars 2015.

- **Totali i shpenzimeve administrative** ka arritur në kuotën prej 9.81%, konkretisht në shumën prej 12,866.56 €. Planifikimi vjetor i kësaj kategorie është 131.200.00 €. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – mars 2015.

TABELA 1

TË HYRAT DHE SHPENZIMET OPERATIVE PËR PERIUDHËN JANAR – MARS 2015


	EMËRTIMI	Realizimi Janar - Mars 2015	Buxheti i Planifikuar 2015	Diferenca	B/C (%)	Realizimi Janar – Mars 2014
	A	B	C	D	E	F
A	Shitjet					
1	Transporti i mallrave	501,561.03	2,653,841.23	-2,152,280.20	18.90	441,733.05
2	TU – Ministria e Infrastrukturës	0.00	1,141,307.84	-1,141,307.84	0.00	240,554.37
3	TU – Ministria e Zhvillimit Ekonomik	125,000.00	500,000.00	-375,000.00	25.00	125,000.00
4	TU – Shitja e Biletave	48,773.50	241,135.05	-192,361.55	20.22	60,833.76
5	Shërbimet tjera	53,246.23	74,686.68	-21,440.45	71.29	14,179.95
6	Të ardhurat – Dëmtimi i vagonëve	6,791.38	145.000.00	-138,208.62	4.68	48,452.76
7	Të hyrat tjera jo operative	10,946.99	60,000.00	-49,053.01	18.24	16,484.21
I	TOTAL – TË HYRAT	746,319.13	4,815,970.80	-4,069,651.67	15.50	947,238.10
B	Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve					
1	Derivatet dhe lubrifikuesit	254,131.92	1,201,500.00	-947,368.08	21.15	225,883.47
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	23,952.40	52,500.00	-28,547.60	45.62	22,063.51
3	Inventar dhe pajisje	24.90	31,000.00	-30,975.10	0.08	0.00
4	Material harxhues	0.00	5,300.00	-5,300.00	0.00	0.00
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	11,127.79	122,114.24	-110,986.45	9.11	11,091.88
6	Qasja në binarë	121,405.25	960,200.00	-838,794.75	12.64	229,285.10
7	Sigurimi i palëve të treta	0.00	13,000.00	-13,000.00	0.00	0.00
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	45,803.55	181,000.00	-135,196.45	25.31	35,425.53
9	Shpenzimet e transportit Infrakos	13,209.90	64,800.00	-51,590.10	20.39	11,661.66
10	Blerje/shpenzime të tjera			0.00		157.00
	TOTAL – KOSTOJA E SHERBIMIT	469,655.71	2,631,414.24	-2,161,758.53	17.85	535,568.15
	Fitimi (humbja) bruto	276,663.42	2,184,556.56	-1,907,893.14	12.66	411,669.95
C	Shpenzimet e stafit					
1	Pagat dhe kontributet	425,580.99	1,625,750.00	-1,200,169.0	26.18	366,373.33
	Sigurimi shëndetësor, trajnime dhe Shpenzime tjera	1,453.00	13,000.00	-11,547.00	11.18	10,234.88
	TOTAL - Shpenzimet e stafit	427,033.99	1,638,750.00	-1,211,716.01	26.06	376,608.25
D	Shpenzimet operative					
1	Mirëmbajtja dhe riparimi i objekteve	190.00	47,700.00	-47,510.00	0.40	853.45
2	Sigurimi fizik – total	6,650.07	45,000.00	-38,349.93	14.78	9,408.05
3	Shërbimet tjera	150.72	3,000.00	-2,849.28	5.02	0.00
4	Shpenzimet logjistike	7,108.82	31,000.00	-23,891.18	22.93	7,730.85

5	Energjia elektrike dhe shërbimet komunale	433.18	1,500.00	-1,066.82	28.88	9,061.07
6	Sigurimi i palëve të treta	1,432.52	10,000.00	-8,567.48	14.33	202.80
8	Marketingu	630.90	19,500.00	-18,869.10	3.24	126.00
9	Udhëtimet zyrtare	1,799.00	30,000.00	-28,201.00	6.00	7,883.33
10	Telefonat dhe Posta	5,564.88	25,000.00	-19,435.12	22.26	2,882.51
11	Shërbimet bankare	534.63	3,000.00	-2,465.37	17.82	350.18
12	Tatimet	373.48	12,000.00	-11,626.52	3.11	677.20
13	Pajisje elektronike	429.68	17,200.00	-16,770.32	2.50	2,702.42
14	Zbritjet e lejuara	3,077.32		3,077.32		12,581.55
	TOTAL - Shpenzimet operative	28,375.20	384,900.00	-356,524.80	7.37	54,459.41
E	Shpenzimet administrative					
1	Inventar dhe pajisje	263.50	5,000.00	-4,736.50	5.27	0.00
2	Konsulenca dhe auditimi i jashtëm	394.00	14,500.00	-14,106.00	2.72	6,810.34
3	Material i zyrës	3,306.04	15,000.00	-11,693.96	22.04	2,151.66
4	Material sanitar	965.16	13,000.00	-12,034.84	7.42	788.63
5	Qiraja për objektet	2,061.85	10,000.00	-7,938.15	20.62	2,224.24
6	Reprezentacioni dhe bufeja	2,493.29	13,000.00	-10,506.71	19.18	2,615.16
7	Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet	30.00	15,000.00	-14,970.00	0.20	64.00
8	Shpenzimet logjistike	1,476.66	15,700.00	-14,223.34	9.41	785.05
9	Kontigjente	1,876.06	30,000.00	-28,123.94	6.25	5,592.50
	TOTAL - shpenzimet administrative	12,866.56	131,200.00	-118,333.44	9.81	21,031.58
II	TOTAL -SHPENZIMET (B+C+D+E)	937,931.46	4,786,264.24	-3,848,332.78	19.60	987,667.39
III	Fitimi (Humbja) para zhvlersimit	-191,612.33	9,706.56	-221,318.89	- 645.02	-40,429.29
	GRANTET	223,809.29	223,809.29	0.00	100.00	
F	Shpenzimet e zhvlerësimit					
1	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i granteve	223,809.29	874,000.56	-650,191.27	25.61	180,597.85
2	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i kompanisë	14,682.02	0.00	0.00	0.00	56,920.51
	TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit	238,491.31	874,000.56	-635,509.25	27.29	237,518.38
G	Fitimi (humbja) nga veprimtaria	-206,294.35	-844,294.00	-1,050,588.35	24.43	-277,947.67


Koment

- Humbja e paraqitur para zhvlerësimit ne vlerë -191.612.33€, është si rezultat i mos realizimit te të ardhurave nga Transporti i Udhëtareve - Ministria e Infrastrukturës, e cila nuk e ka nënshkruar marrëveshjen për mbulimin e pjesshëm të obligimeve (kjo marrëveshje nuk i mbulon te gjitha humbjet e krijuara nga transporti i udhëtareve) ku vlera e tyre për këtë periudhë është e planifikuar në vlerë prej 285.326.97 Euro.

Diagrami 1 – Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit janar – mars 2015



Diagrami 2 – Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive janar – mars 2015



1. Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas bankës (31.03.2015)

Nr	EMËRTIMI	Saldo 31-03-15
	PCB nr. 1114-004229-0001-59	605,659.46
	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	24,989.00
	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	95,369.57
	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	144,559.56
	OSHP – PCB nr. 1114 – 004229 -0401-23	**143,364.13**
	Totali	**1,013,941.70**

IV. PERFORMANCA OPERATIVE

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim indikatorët fizikë të performancës operative gjatë periudhës tre mujore nga 01 janari 2015 deri më 31 mars 2015. Realizimi operativ gjatë kësaj periudhe pasqyron arritjen e objektivave të planifikuara për këtë periudhe duke krahasuar edhe me realizimin e vitit paraprak 2014, për të njëjtën periudhë kohore. Gjithashtu, janë dhënë komentet për ndryshimet që kanë ndodhur gjatë kësaj kohe.

Departamenti i Operimeve, gjatë këtij tre mujori, nga 01 janar 2015 deri me 31 mars 2015, është munduar që të ketë një koordinim të mirë si brenda për brenda Departamentit nëpër Sektorë ashtu edhe me Departamentin e Administratës, Departamentit të Zhvillimit të Bizneseve si dhe Zyrës së Kontrollit ku nga vërejtjet dhe sugjerimet e tyre kemi bëre ndryshime që kanë qenë të mirëseardhura për kompaninë.

Përkundër numrit të vogël të mjeteve lëvizëse si dhe gjendjes së tyre jo shumë të mirë teknike për shkak të vjetërsisë, ne kemi arritur t'i mbajmë në operim të gjithë trenat sipas planit të paraparë në orarin e lëvizjes së trenave për vitin 2015. Kjo gjë ka ndodhur falë angazhimit të madh të personelit ekzekutiv, menaxhues por edhe personelit që operon me këto mjete, si dhe personelit që kujdesen për mirëmbajtjen e tyre.

Në Sektorin e Transportit të Mallrave, kemi pasur kontakte të përhershme me Menaxherin lidhur me ecurinë mbarëvajtjes se punëve.

Sektori i transportit të udhëtarëve, për këta tre muaj ka vazhduar koordinimin e punëve me Zyrën e Sektorit te Kontrollit në dhënien e propozimeve për kontrollin e trenave të udhëtarëve.

Ndërsa në Sektorin e MML, përkundër problemeve që kemi pasur kemi arritur të operojmë me një stabilitet të mirë duke i plotësuar të gjitha kërkesat për mirëmbajtje.

IV. 1. Transporti i mallrave

Në Sektorin e Transportit të Mallrave, i cili luan rolin kryesore për ne, gjatë periudhës tre mujore respektivisht nga 01 janar 2015 deri me 31 mars 2015, kemi pasur këto rezultate:

Përshkrimi – Sasia e Transportuar	Janar – Mars
Realizimi Neto Ton në 2014	169,640.68 Ton
Realizimi Neto Ton në 2015	205,971.45 Ton
Planifikimi Neto Ton në 2015	228,529.92 Ton
Dallimi: Realizim 2015 – Realizim 2014	36,330.77 Ton
Dallimi: Realizim – Planifikim në 2015	- 22,558.47 Ton
Dallimi: Realizim 2015 – Realizim 2014 (%)	+ 21 %
Dallimi: Realizim 2015 – Planifikim 2015 (%)	- 10 %

Tabela 1.1

- Transporti i mallrave me kontejnera për këtë vite ka qenë:

Përshkrimi – Numri i Transportuar i kontenjerave	Janar – Mars 2015
Kontenjera të plotë - 2015	536.00 copë
Kontenjera të zbrazët - 2015	0 copë

Tabela 1.2

Siç mund të shihet nga tabela 1.1, në këtë periudhë kohore kemi transportuar për rreth 21 % më shumë se sa në të njëjtën periudhe raportuese për vitin e kaluar, si dhe më pak për rreth 10% se sa sasia e planifikuar për këtë periudhë.




Figura 1.1

Siç mund të shihet nga figura 1.1 në aspektin operativ kemi një rritje të konsiderueshme. Më poshtë të dhënat e vlerave Neto/Ton janë të shprehura në të hyra me vlerë Euro.

Përshkrimi - Të hyrat	*Janar – Mars*
Të hyrat nga transporti Janar - Mars 2014	**441,768.30**
Të hyrat nga transporti Janar – Mars 2015	**501,561.03**
Planifikimi Janar – Mars 2015	**663,460.30**
Dallimi realizim 2015 - realizim 2014	**59,792.73**
Dallimi realizim - planifikim 2015	**- 161,899.27**
Dallimi realizim 2015 - realizim 2014 në %	**+ 14.00 %**
Dallimi realizim - planifikim 2015 në %	**- 24.00 %**

Tabela 1.3




Figura 1.2

Ndërsa reflektimi financiar i transportit të mallrave, siç mund të shihet nga shënimet më lart në këtë periudhë kohore është arritur të krijohen të hyra për rreth 14 % më shumë se sa vitin e kaluar për të njëjtën periudhë, ndërsa kemi më pak nga planifikimi për 24 % për periudhën raportuese.

IV. 1.1. Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i mallrave

Përshkrimi	Janar – Mars
Të hyrat nga transporti i mallrave	501,561.03
Të hyrat nga shërbimet tjera të transportit të mallrave	60,037.61
Total shitjet	561,598.64
Shpenzimet direkte në transportin e mallrave	339,749.02
Shpenzimet indirekte në transportin e mallrave	86,892.82
Total shpenzimet	426,641.84
Fitimi/humbja operative	+ 134,956.80
Fitimi/humbja operative me përqindje %	+ 32%

Tabela 1.3

Në shitjet nga shërbimet e tjera të transportit të mallrave hyjnë***:

- ✓ Të ardhurat nga transportimi i kontejnerëve me vlerë: **41,580.00 €**
- ✓ Të ardhurat nga RIV dhe vendosja me vlerë: **11,666.23 €**
- ✓ Të ardhura tjera nga riparimi/dëmtimi i vagonëve me vlerë: **6,791.38 €**

Siç shihet nga tabela më lart biznesi i transportit të mallrave ka operuar me një fitim operativ prej 32 **%** gjatë periudhës raportuese.

Vërejtje:
Shpenzimet indirekte janë përllogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave për këtë tremujor duke marrë për bazë tren - kilometrat, ku ka rezultuar se trenat e mallrave kanë operuar rreth ***28 %*** *nga totali i tren - kilometrave që kanë operuar të gjithë trenat.*

IV. 1. 2. Neto Ton & Neto Ton Kilometër të Transportuar

Import – 35.401.68 t kemi 77 % neto ton të realizuar nga 46.108.60 t neto ton të planifikuar për këtë periudhë - Neto ton kilometër janë 231.9134 t/km.
Eksport – 11.908 t kemi 60 % neto ton të realizuar nga 19,760.84 t neto ton të planifikuar për këtë periudhë - Neto ton kilometër janë 791.099 t/km.
Vendor – 122,331 t kemi 24 % **rritje** neto ton të realizuar nga 98.804.16 t neto ton të planifikuar për këtë periudhë – Neto – ton kilometër janë 372.4996 t/km.
Totali: – 169.640.68 t kemi 3 % **rritje** neto ton të realizuar nga 164.673.60 t neto ton të planifikuar për këtë periudhë.

IV. 1. 3. Mallrat e transportuara

Kemi transportuar mallra të ndryshme dhe nga 100 % të mallrave të transportuara kemi: Xehe 72 %, Derivate 14 %, Plin 5 %, Mall i përzier 1 %, laminat 1 %, lëngje 1 %, llamarinë 1 %, thëngjill 1 %, dru i bluar 1 % dhe lesh qelqi 1% të paraqitur si ne figurën 1.4.




Figura 1.4

IV. 1. 4. Organizimi i tërheqjes me lokomotiva & manovruese – Shpenzimet e naftës dhe kilometrat e kaluara

Shpenzimet e naftës dhe kilometrat e kaluara për lokomotivat dhe manovrueset tërheqëse në transportin e mallrave për këtë periudhë tre mujore janë të paraqitura në tabelën më poshtë:

Lokomotivat tërheqëse dhe manovruese - Transporti i Mallrave							
		2640-007	2710-009	2640-010	2760-001	2760-002	Gjithsejtë njësit për muaj
Janar	nafte (l)	27,120.00	6,250.00	8,400.00	0.00	1111	42,881.00
	km	6,023.00	1,409.00	2,602.00	0	602	10,636.00
	liter/km	4.50	4.44	3.23	0	1.85	
Shkurt	nafte (l)	22,800.00	0.00	11,700.00	330	720	35,550.00
	km	4,924.00	0	3470	168	410	8,972.00
	liter/km	4.63	0	3.37	2.00	1.75	
Mars	nafte (l)	24,500.00	0.00	10,900.00	813.00	0	36,213.00
	km	5,179.00	0.00	2,724.00	440	0	8,343.00
	liter/km	4.73	0	4.02	1.9	0	
Janar - Mars	nafte (l)	74,420.00	6,250.00	31,000.00	1,143.00	1,831.00	114,644.00 Litra
	km	16,126.00	1,409.00	8,796.00	608.00	1,012.00	27,951.00 km
	liter/km	4.61	4.44	3.52	1.88	1.81	4.10 L/km

Tabela 1.5

IV. 2 Transporti i Udhëtarëve

- Biletat e shitura: 64.661
- Numri i udhëtarëve: 66.607
- Të hyrat: **48,773.52** €.

Më poshtë paraqesim tabelën e krahasimit të dhënave të realizuar gjatë kësaj periudhe me të dhënat e periudhës së njëjtë të vitit të kaluar kemi këtë rezultat:

	Realizimi në 3 mujorin e Vitit 2014	Realizimi në 3 mujorin e Vitit 2015	Ndryshimi në %
Numri i Udhëtarëve	91,283	66,607	- 27.03 %
Të hyrat pa TVSH	59,421.00 €	48,773.52 €	- 17.92 %

IV. 2.1. Organizimi dhe Realizimi i Transportit të Udhëtarëve

Në tabelën më poshtë janë paraqitur krahasimet e përgjithshme të të dhënave të realizuara nga janar – mars 2015, me periudhën tre mujore të njëjtë të vitit 2014. Nga kjo shihet se kemi një rënie të numrit të udhëtarëve gjatë periudhës raportuese.

Përshkrimi - Udhëtarë	Janar – Mars
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2014	91,283
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2015	66,607
Planifikimi i numrit të udhëtarëve në 2015	92,349
Dallimi: Realizim 2015 - 2014	- 24,676
Dallimi: realizim - planifikimi 2015	- 25,742
Dallimi: 2015 - 2014	- 27.03 %
Dallimi: realizim - planifikimi 2015	- 27.87 %

Tabela 2.1

Siç shihet nga shënimet e paraqitura më lart, sa i përket transportit të udhëtarëve për këtë periudhë kohore, kemi pasur një numër të udhëtarëve më të vogël krahasuar me vitin e kaluar, me një rënie prej **27.03 %,** ndërsa **27.87 %** më pak se sa planifikimi për ketë tremujor.

Të hyrat nga shitjet e biletave	Janar – Mars
Realizim shitje të hyra 2014	60,833.76 €
Realizim shitje të hyra 2015	48,773.52 €
Planifikimi 2015	53,954.44 €
Dallimi: realizim 2015 - realizim 2014	- 12,060.24 €
Dallimi: realizim - planifikim 2015	- 5,180.92 €
Dallimi: realizim 2015 - realizim 2014	- 19.82 %
Dallimi: realizim - planifikim 2015	- 9.60 %

Tabela 2.2




Figura 2.1

Reflektimi financiar nga transporti i udhëtarëve, siç mund të shihet nga shënimet më lart në këtë periudhë kohore, ka krijuar të hyra nga shitja e biletave për rreth **19.82 %** më pak se sa në të njëjtën periudhë të vitin të kaluar dhe rreth **9.60 %** më pak sesa planifikimi për këtë periudhë.

IV. 2.2. Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i udhëtarëve

Përshkrimi - Të hyrat	Janar - Mars
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - OSHP	0.00 €
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - MZHE	125,000.00 €
Të hyrat nga shitjet e biletave	48,773.52 €
Total të hyrat	173,773.50 €
Shpenzimet direkte në transportin e udhëtarëve	287,850.94 €
Shpenzimet indirekte në transportin e udhëtarëve	223,438.69 €
Total shpenzimet	511,289.63 €
Fitimi / humbja operative	- 337,516.13 €

Tabela 2.3

Siç shihet nga tabela më lart biznesi i transportit të udhëtarëve ka operuar me një humbje operative prej **– 66 %** gjatë periudhës raportuese, duke llogaritur të hyrat nga: OSHP, MZHE - ja si dhe të hyrave nga shitja e biletave të udhëtareve dhe transporteve të kontraktuara.

Vërejtje:

*- Shpenzimet indirekte janë përllogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave për këtë tremujor duke marrë për bazë tren - kilometrat, ku ka rezultuar se trenat e udhëtarëve kanë operuar rreth **72 %** nga totali i tren - kilometrave që kanë operuar të gjithë trenat.*

IV. 2.2. Organizimi i tërheqjes së trenave me lokomotiva dhe trenat motorikë - Shpenzimet e naftës dhe kilometrat e kaluara

Shpenzimet e naftës dhe kilometrat e kaluara për lokomotivat dhe trenat motorikë në transportin e udhëtareve për këtë periudhë tre mujore janë të paraqitura në tabelën më poshtë:

Lokomotivat tërheqëse dhe manovruese - Transporti i Udhëtareve							
		2640-005	**2620-001**	**2640-003**	**5800-001**	**5800-004**	**Gjithsejtë për muaj**
Janar	**nafte (l)**	15,000.00	0	25,820.00	2,485.00	8,206.00	51,511.00
	km	3,592.00	0	8,530.00	2,798.00	9,726.00	24,646.00
	liter/km	4.18	0	3.03	0.89	0.84	2.090034894
Shkurt	**nafte (l)**	6,060.00	5,700.00	18,655.00	855	7,560.00	38,830.00
	km	1,474.00	2,626.00	6,372.00	872	9,848.00	21,192.00
	liter/km	4.11	2.17	2.93	0.98	0.77	1.832295206
Mars	**nafte (l)**	7,150.00	7,500.00	28,450.00	90	7,870.00	51,060.00
	km	1,704.00	1,995.00	9,845.00	126	11,110.00	24,780.00
	liter/km	4.20	3.76	2.89	0.71	0.71	2.060532688
Janar - Mars	**nafte (l)**	28,210.00	13,200.00	72,925.00	3,430.00	23,636.00	**141,401.00 Litra**
	km	6,770.00	4,621.00	24,747.00	3,796.00	30,684.00	**70,618.00 km**
	liter/km	4.17	2.86	2.95	0.90	0.77	**2.00 l/km**

Tabela 2.4

IV. 3. Mirëmbajtja

Në fushën e Sektorit të Mirëmbajtjes së trenave motorikë, lokomotivave, lokomotivave manovruese, vagonëve për transportin e udhëtareve si dhe vagonëve për transportin e mallrave gjatë periudhës kohore të raportimit prej 01.01.2015 deri me 31.03.1014, kemi pasur këto rezultate.

IV. 3.1. Matja e produktivitetit në shfrytëzimin e fuqisë punëtore

Matja e shfrytëzimit të fuqisë punëtore tregon se sa dhe ku shfrytëzohet më tepër fuqia punëtore dhe tregon raportin në mes fuqisë punëtorë në dispozicion dhe fuqisë punëtore të shfrytëzuar.

Shërbimi i mirëmbajtjes së Lokomotivave gjatë periudhës janar – mars ka disponua me fuqi pune prej 9.262.5 orë ku: 5.635 orë, janë shfrytëzuar për riparim apo 60.84 % e fondit total të orëve, 914 orë, janë shfrytëzuar për punë ndihmëse dhe dytësore apo 9.87 % e fondit total të orëve, Produktiviteti i tërë ka qenë 70.70 %.

Shërbimi i mirëmbajtjes së vagonëve gjatë periudhës janar – mars ka disponuar me fuqi pune prej 6.331.5 orë ku: 3.764 orë, janë shfrytëzuar për riparim apo 59.44 % e fondit total të orëve, 704 orë, janë shfrytëzuar për punë ndihmëse dhe dytësore apo 11.11 % e fondit total të orëve, Produktiviteti i tërë ka qenë 70.56 %.

Intervenimet në mjetet tërheqëse gjatë tremujorit të parë janar – mars për secilin mjet kanë qenë:

Lok.	2620 005	2640 006	2640 007	2640 008	2640 001	2640 003	2640 004	2710 009	2640 -010	MDD3 - 01	MDD3 - 02	TM - 01	TM - 02	TM - 03	TM - 04
S	17	0	18	0	11	50	0	2	19	1	0	22	0	0	78
R	6	0	3	0	7	110	0	2	4	1	3	8	0	0	6
K 1	2	0	2	0	1	2	0	0	2	2	1	1	0	0	1
K 3	1	0	1	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
K 6	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0

Tabela 3.1

V. PROJEKTET KAPITALE NË TRAINKOS SH.A

Zyra e Prokurimit sipas buxhetit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve dhe alokimit të mjeteve si dhe në përputhje me planin e prokurimit ka zhvilluar procedurat e prokurimit për projektet të cilat kanë qenë pjesë e buxhetit të aprovuar të cilat janë dhënë në tabelën e mëposhtme:

Titulli i Aktivitetit te Prokurimit	Kontraktuar	Buxheti i zotuar	Vlera e kontrates	Koment
Furnizimi me lokomotive dizel elektrike me riparim gjeneral për transport te kombinuar (mallra – udhëtarë)		1,100,000.00		Në procedurë
Riparimi gjeneral me konvertim i dizel motorit dhe kompresorit te lokomotivës 004		210,000.00		Në procedurë
Shërbimet e sigurimit fizik	Mars	45,000.00	35,000.00	Në zbatim
Auditimi i pasqyrave financiare	Janar	5,000.00	4,950.00	Në zbatim
Ndërrimi i rrotave të vagonëve	Janar	36,000.00	35,890.00	Përfunduar
Furnizimi me papuçe frenuese për lokomotiva dhe vagonë	Janar	20,000.00	18,629.00	Përfunduar
Furnizimi me material higjienik	Janar	8,000.00	7,989.14	Në zbatim
Shërbimet e sigurimit të palëve të treta	Janar	6,500.00	6,462.00	Në zbatim
Furnizimi me rroba mbrojtëse	Shkurt	40,000.00	25,394.90	Në zbatim
Kontrolli sistematik i punëtoreve	Mars	5,000.00	5,000.00	Në zbatim
Furnizimi dhe riparimi i ndërruesit të shpejtësive për veturë	Mars	2,200.0	2,130.00	Në zbatim
Furnizimi me pjesë për servisimin e automjeteve	Mars			Në zbatim
Furnizimi me inventar për zyra	Mars	3,500.00	1,435.00	Përfunduar
Furnizimi dhe Instalimi i sistemit softuerik të hyrje - daljeve të personelit		6,500.00		Në procedurë
Shërbimet e sigurimit të veturave	Mars	2,000.00	1,812.30	Në procedurë
Furnizimi me pjesë për servisimin e automjeteve	Mars	3,100.00	1,485.00	Perfunduar
Furnizimi dhe montimi me gjenerator		9,000.00		Në procedurë

1. Furnizimi me lokomotive dizel elektrike me riparim gjeneral për transport të kombinuar (mallra – udhëtarë)

Projekti për furnizim me lokomotivë të riparuar është tenderuar dhe është përzgjedhur operatori ekonomik fitues. Janë përfunduar të gjitha procedurat e tenderimit dhe janë plotësuar kushtet për kontraktim. Për shkak se AKK e kanë përcjellë nga fillimi këtë projekt, kanë kërkuar dosjen e tenderit dhe të gjithë dokumentacionin për vlerësim nga ana e tyre. Jemi në pritje të përgjigjes.

2. Riparimi gjeneral me konvertim i dizel motorit dhe kompresorit të lokomotivës 004

Projekti për riparim gjeneral dhe konvertim i motorit të lokomotivës 004 është tenderuar dhe po ashtu është vlerësuar. Komisioni kanë rekomanduar dhënien e kontratës. Jemi në pritje të konfirmimit të buxhetit të alokuar në mënyrë që të procedohet më tutje.

3. Sigurimi fizik i objekteve të Trainkos Sh.A.

Projekti për sigurim fizik të objekteve është kontraktuar dhe është ne zbatim. Kontrata është kontratë kornizë në kohëzgjatje prej një viti.

4. Auditimi i pasqyrave financiare

Projekti për auditim të pasqyrave financiare është kontraktuar dhe është në zbatim e sipër. Operatori ekonomik është në përfundim e sipër të kontratës.

5. Riparim i rrotave te vagonëve

Projekti për riparim të rrotave të vagonëve është projekt që është kontraktuar dhe i njëjti është i përfunduar dhe i pranuar teknikisht .

6. Furnizimi me papuçe frenuese për lokomotiva dhe vagonë

Projekti për furnizim me papuçe frenuese është i kontraktuar dhe i njëjti është i përfunduar. Komisioni ka pranuar teknikisht mallin.

7. Furnizimi me material higjienik

Projekti është kontraktuar dhe është ne zbatim e sipër.

8. Shërbimet e sigurimit të palëve të treta

Shërbimi është kontraktuar dhe kontrata është valide për një vit kalendarik.

9. Furnizimi me rroba mbrojtëse dhe uniforma

Projekti për furnizim me rroba mbrojtëse dhe uniforma është kontraktuar dhe i njëjti është ne zbatim e sipër.

10. Kontrolli sistematik i punëtorëve

Projekti për kontroll sistematik është kontraktuar me procedura të negociuara dhe i njëjti është kontraktuar me Institutin e Mjekësisë se Punës dhe është në zbatim e sipër.

11. Furnizimi dhe riparimi i ndërruesit te shpejtësi për IX 35

Projekti është përfunduar dhe është pranuar teknikisht.

12. Furnizimi me pjesë për servisimin e automjeteve

Projekti është i kontraktuar dhe i njëjti ka përfunduar dhe pranuar teknikisht.

13. Furnizimi me inventar për zyre

Kontrata është nënshkruar dhe është realizuar ne tërësi. Malli është pranuar teknikisht.

14. Furnizimi dhe Instalimi i sistemit softuerik te hyrje- daljeve te personelit

Projekti është tenderuar dhe kanë përfunduar te gjitha procedurat deri në vlerësim. Për të njëjtin kemi ankesë ne OSHP dhe është në shqyrtim e sipër nga eksperti i tyre.

15. Shërbimet e sigurimi i veturave

Kontrata është nënshkruar dhe është në zbatim e sipër.

16. Furnizimi dhe montimi me gjenerator

Projekti ka dështuar disa herë në mungesë të ofertave të përgjegjshme teknikisht. I njëjti është ri tenderuar.

VI. KONTESTET GJYQËSORE NË PERIUDHËN JANAR - MARS 2015

Departamenti i Administratës, Sektori për çështje Ligjore dhe Resurse Njerëzore gjatë periudhës 01.01.2014 – 31.12.2014, ka mbajtur gjithsej 10 seanca gjyqësore nga të gjitha kategoritë e kontesteve që gjenden në procedurë, por ka kryer edhe punë të tjera për të cilat do t'u informojmë më sa vijon:

Kontestet nga marrëdhënia e punës
Kontestet për kompensim të dëmit
Kontestet për pagimin e borxhit
Lëndët penale

Kontestet nga marrëdhënia e punës

Nga marrëdhënia e punës gjatë këtij tremujori kemi pasur 4 seanca gjyqësore:

1. Kontesti sipas lëndës C. nr. 387/08, paditës **Fadil Hasani,** i larguar në vitin 2006;
2. Kontesti sipas lëndës C. nr. 999/12, paditës **Ibrahim Tërrnava,** i larguar në vitin 2001;
3. Kontesti sipas lëndës C. nr. 2171/13, paditës **Gani Bullatovci,** i larguar në vitin 2006;
4. Kontesti sipas lëndës C. nr. 2154/13, paditës **Ahmet Krasniqi,** i larguar në vitin 2001;

Gjatë kësaj periudhe nga Gjykata Themelore në Prishtinë kemi pranuar 2 padi: **(konteste pune)**

1. Kontesti sipas lëndës C. nr. 2671/12, paditës **Mirko Trajkoviq,** i larguar nga Trainkos SH.A. me dt. 04.09.2012 Zyra Ligjore ka përgatitur Përgjigjen në padi.

2. Kontesti sipas lëndës C. nr. 432/13, paditës **Stankoviq Radisha,** i larguar nga Trainkos SH.A. në vitin 2012.

Nga kontestet e punës gjatë kësaj periudhe në shkallë të parë në rigjykim ka përfunduar kontesti me paditësin **Fadil Hasani**, pritet aktgjykimi nga Gjykata Themelore e Prishtinës.

Kontestet për kompensim dëmi

Nga kontestet për kompensim dëmi gjatë këtij tremujori në procedurë kemi pasur 2 konteste:

1. Kontesti sipas lëndës C. nr. 309/10, **Familja Gaxhiqi** nga Klina, të cilës i ka vdekur anëtari i familjes Ajet Gaxhiqi, në aksidentin e dt. 24.08.2008.

2. Kontesti sipas lëndës II. C. nr. 711/2013, **Transporti hekurudhor Sh.p.k.Obiliq**.

Gjatë kësaj periudhe kemi pranuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë tri lëndë të reja:

1. Kontesti sipas lëndës C. nr. 1276/2010, paditëse **Shukrije Shabani,** e cila ka pësuar lëndime trupore në aksidentin e dt. 02.03.2010, vlera e kontestit: 8.500.00 €. Zyra Ligjore ka ushtruar Përgjigje në padi nr. 120 të dt. 20.02.2015, të cilën ia ka dorëzuar gjykatës në afatin ligjor**. (Ende nuk ka filluar procesi gjyqësor**)

2. Kontesti sipas lëndës C. nr. 1111/13, Genc Berisha i cili në aksidentin e dt. 14.08.2013 ka pësuar lëndime trupore dhe dëme materiale në veturë, vlera e kontestit: 4.500.00 €, Zyra Ligjore ka ushtruar Përgjigje në padi nr. 190 të dt. 20.03.2015, të cilën ia ka dorëzuar gjykatës në afatin ligjor**. (Ende nuk ka filluar procesi gjyqësor**)

3. Kontesti sipas lëndës 1954/10, paditës **Ilmi Hasani,** i cili gjatë ushtrimit të detyrës së konduktorit në trenin i cili qarkullonte në relacionin Fushë Kosovë – Hani i Elezit me dt. 29.12.2007, është sulmuar nga persona të panjohur. Zyra ligjore ka ushtruar Përgjigje në padi me nr. 139 të dt. 03.03.2015, të cilën ia ka dorëzuar gjykatës në afatin ligjor.
(**Ende nuk ka filluar procesi gjyqësor**)

Nga Gjykata e Apelit e Kosovës një aktgjykim në favor të Trainkos SH.A.

1. Aktgjykimi A. C. nr. 3547/2012, i dt. 12.01.2015, në favor të Trainkos SH.A. paditës **Familja Jaha** nga fshati Stagovë K.Kaçanik, e cila ka humbur anëtarin e familjes në aksidentin e ndodhur me **dt. 03.07.2009**, Vlera e kontestit: **6.000.00 €,** (Aktgjykimi është i plotfuqishëm)

Kontestet e borxhit

Nga kontestet e borxhit kemi mbajtur 2 seanca gjyqësore me paditësin **NTP "LINDI"** me seli në Viti.

Janë përgatitur 2 padi të reja për pagimin e borxhit në emër të kryerjes së shërbimeve të transportit të mallrave.

1. E paditur **N.T. "Liridoni"** me seli në Pejë, vlera e kontestit: 4.216.00 €.

2. E paditur **Oraca** me seli në Prishtinë, vlera e kontestit: 3.553.20 €.

Të tjera

Gjatë kësaj periudhe po ashtu kemi bërë përcjelljen e Revizioneve të arritura nga Gjykata Supreme e Kosovës, ankesave, parashtresave, përgjigjeve në padi, përgjigjeve në ankesa, të gjitha duke respektuar afatet ligjore të caktuara nga gjykatat kompetente.

Më dt. 09.01.2015, Doganës së Kosovës, i kemi dorëzuar dëshminë mbi pagesën e dënimit në vlerë prej 1.000.00 €, duke u bazuar në aktvendimit 04.2.3.1/736, 739, 740 të dt. 30.10.2012, sepse me datën 08.09.2012, punëtori përgjegjës i Trainkos SH.A. ka zhvendosur mallin nga vendi i caktuar pa pëlqimin e Doganës.

Më dt. 16.02.2015, është bërë pranimi i Ankesës kundër Aktgjykimit C. nr. 209/09, të dt. 19.11.2014, të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Drenas, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë nga e autorizuara e paditësve **Hajdin Osmani dhe Naim Tafilaj,** të cilët pësuan lëndime të rënda trupore në aksidentin e ndodhur me dt. 24.08.2008, me të cilin Aktgjykim është Aprovuar Pjesërisht padia dhe kërkesëpadia e paditësve. Është përgatitur përgjigja në Ankesën e ushtruar nga ana e të autorizuarës së paditësve. Pritet aktgjykimi nga Gjykata e Apelit në Prishtinë.

Më dt. 16.02.2015, nga Gjykata Themelore në Ferizaj, ka arritur Aktgjykimi C. nr. 310/10, në favor të Trainkos SH.A. Paditëse **Hamide Goxha.** Lënda Kontestimore – Kompensim dëmi. Vlera e kontestit: 30.665.33 €. Paditësi ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, pritet aktgjykimi nga Gjykata e Apelit.

Më dt. 16.02.2015, nga Gjykata Supreme e Kosovës ka arritur aktgjykimi sipas Revizionit Rev.nr. 160/2011, sipas të cilit refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës Trainkos SH.A. i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC. nr. 386/2009, e dt.

22.03.2011, në pjesën me të cilën është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C. I. Nr. 143/2008, e dt. 26.12.2008, që ka të bëjë me anulimin si jo të ligjshëm të vendimit të paditurës, me të cilin paditësit Ahmet Krasniqit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, ndërsa Pranohet revizioni i të Paditurës dhe prishet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC. nr. 386/2009, e dt. 22.03.2011, në pjesën me të cilën është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C. I. Nr. 143/2008, e dt. 26.12.2008, në pjesën që ka të bëjë me detyrimin e të paditurës, që paditësit t'ia njoh të drejtat nga marrëdhënia e punës nga data e largimit e deri në datën e kthimit në punë si dhe kompensimin e shpenzimeve të procedurës, ndërsa lënda në këtë pjesë i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim. (Gjykata Supreme e Kosovës e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit Ahmet Krasniqi si të bazuar, kurse në rigjykim e ka kthyer pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me precizimin e periudhës kontestuese prej dt. 28.02.2001 deri me dt. 01.06.2006, për kompensimin e pagës, pasi që Vendimin mbi shkuarje në pritje të pensionit gjykata e ka anuluar si të kundërligjshëm sepse paditësi Ahmet Krasniqi nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për të shkuar në pritje të pensionit në vitin 2001, sepse nuk i ka pas 65 vjet. Në rigjykim është caktuar ekspertiza financiare për llogaritjen e të ardhurave personale për periudhën 28.02.2001 deri me 01.06.2006, kur paditësi është kthyer në punë në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm).

Me dt. 16.02.2015, nga Gjykata Supreme e Kosovës Rev. Nr .246/2011, sipas të cilit Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës Trainkos SH.A. i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC. nr. 868/2009, e dt. 26.01.2011, në pjesën me të cilën është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 15/2007, e dt. 11.02.2009, që ka të bëjë me anulimin joligjor të aktvendimit të komisionit disiplinor nr. 1009/4, dt. 22.11.2006, dhe vendimit nr. 1143/2, dt. 27.12.2006, me të cilët paditësit Gani Bullatovcit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, ndërsa Pranohet revizioni i të Paditurës dhe prishet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC. nr. 868/2009, e dt. 26.01.2011, në pjesën me të cilën është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 15/2007, e dt. 11.02.2009, në pjesën që ka të bëjë me detyrimin e të paditurës që paditësit t'ia njoh të drejtat nga marrëdhënia e punës nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga dt. 25.10.2006, e deri në kthimin e tij në punë si dhe kompensimin e shpenzimeve të procedurës, ndërsa lënda në këtë pjesë i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe kërkohet nga paditësi që të precizoi kërkesëpadinë për periudhën kontestuese. (Në rigjykim Gjykata Supreme e Kosovës ka kërkuar nga paditësi Gani Bullatovci që të precizoi periudhën kontestuese prej dt. 27.12.2006 deri në kthimin e tij në vendin e punës në bazë të kontratës nr. 0289/1 të dt. 03.03.2011, me kohëzgjatje prej dt. 04.03.2011, deri në aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës.)

Me dt. 16.02.2015, nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje Ekonomike ka arritur ftesa për seancë me dt. 18.03.2015, në ora 10:00, sipas lëndës III. C. nr. 343/2014 Paditës: **N. T. P. "Lindi-R".** Vlera e kontestit: 5.766.07 €. (Paditësi në padi, ka kërkuar kompensimin e mallit të humbur gjatë transportimit në vlerën e cekur më lartë).

VII. TRANSAKSIONET E REALIZUARA JANAR - MARS 2015

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse dhe ato në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës:

Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2015	373,753.33 €
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – mars 2015	992,340.31 €
Inkasimet e pranuara gjatë muajve janar – mars 2015	760,434.18 €
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.03.2015	605,659.57 €

Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2015	131,262.57 €
Inkasimet e pranuara gjatë muajve janar – mars 2015	0.00 €
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – mars 2015	35,893.00 €
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.03.2015	95,369.57 €

VIII. SFIDAT KRYESORE NË TREMUJORIN E KALUAR DHE VEPRIMET PËR TË ARDHMEN

Siç edhe është pasqyruar në këtë raport tremujor të kompanisë publike Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A., kanë arritur objektivat e përgjithshme të planifikuar më Planin e Biznesit. Kjo arritje në radhë të parë i dedikohet përkushtimit maksimal të të gjithë strukturës organizative të kompanisë që nga Bordi i Drejtorëve, menaxhmenti e deri tek stafi ekzekutues. Duke pasur parasysh kushtet me të cilat përballet kompania arritja e objektivave është sfide në vete.

Vështirësitë me të cilët përballët kompania Trainkos Sh. A., dallojnë për nga natyra e tyre dhe efektet e shkaktuara nga këto vështirësi ndikojnë në zhvillimin e biznesit tonë.

Aksionari duhet të definojë sa më shpejt disa çështje ligjore, në mënyrë që të garantohet funksionimi normal dhe i qëndrueshëm i kopanisë. Ndër çështjet me më rëndësi të cilat janë shumë emergjente kemi veçuar dy prej tyre:

1. Zbatimi i dispozitave ligjore për OSHP-në, përkatësisht mbulimin e shpenzimeve në transportin udhëtarëve, pasi që këto dispozita ligjore nuk po zbatohen. Marrëveshja për OSHP e nënshkruar nga MI, ketë vit është reduktuar për 110,000.00 €. Në bazë të Ligjit për Hekurudhat marrëveshja për OSHP do të duhet të mbulonte të gjitha shpenzimet në transportin e udhëtarëve. Për Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A., siç edhe shihet në pasqyrimet në këtë raport, mbulimi i shpenzimeve në transportin e udhëtarëve mbetet sfida kryesore, pamundësia e mbulimit të shpenzimeve në këtë shërbim ndikon direkt ne performacën e përgjithshme të kompanisë.

2. E dyta për nga renditja, por jo për nga rëndësia është definimi jo i qartë dhe mungesa e një platforme nga ana e qeverisë për liberalizimin e tregut në transportin hekurudhor. Tendencat për licencimin e operatorit të dytë rrezikojnë kompaninë, një gjë e tillë në bazë të gjitha parametrave rrezikon ekzistencën e kompanisë Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A, me 100 % të aksioneve në pronësi të Qeverisë së Kosovës dhe qytetarëve të sajë .

Sfidat tjera lidhen ngushtë më investimet që kërkohen në flotën e mjeteve lëvizëse, grantet për investime kapitale të ndara nga qeveria janë të pa mjaftueshme për nevojat që ka kompania për investime si në riparimet e mjeteve që posedojmë po ashtu edhe në blerjen e mjeteve të reja lëvizëse.

Sfidë tjetër është edhe mos funksionimi i shumë linjave sidomos atyre që kanë qasje në linjat ndërkombëtare të transportit, ky faktor ndikon në numrin e klientëve dhe rrjedhimisht kufizon mundësitë e zhvillimit të kompanisë.

Aktualisht kompania është duke u ballafaquar me disa procese gjyqësore shumë të ndjeshme nga aspekti juridik dhe mund t'i konsiderojmë si të rrezikshme, kjo natyrshëm na sfidon në raportin e performancës financiare të kopanisë.

Mbetemi të përkushtuar që të zhvillojmë kompaninë Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. në të gjithë sektorët dhe shërbimet që ofrojmë, duke vendosur si qëllim dhe objektiv të përhershëm zhvillimin, profesionalizmin dhe sigurinë në shërbimet që ofrojmë.

Besojmë fuqishëm së në bashkëpunim me Aksionarin, do të arrijmë që të ndërtojmë koncepte të përbashkëta zhvillimore për kompaninë, duke vlerësuar transportin hekurudhor si një arterie shumë të rëndësishme dhe jetike për zhvillimin ekonomik të vendit.

Fushë Kosovë
Prill 2015

Gëlor SHALA
Kryeshef Ekzekutiv i HK – Trainkos Sh.A.